



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

Nr. 200/5 prot.

Tiranë, më 31.07.2026

VENDIM

Nr. 75, datë 31.07.2026

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT, VLERËSIMIT, PIKËZIMIT
DHE RENDITJES SË KANDIDATATURËS TË KANDIDATES ZNJ. DORINA
DERVISHAJ PËR VENDIN VAKANT TË INSPEKTORIT JOMAGJISTRAT,
SHPLLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MË DATË 26.05.2026”**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Z. Eugen Nasufi - Kryetar

Znj. Daniela Sulaj – Anëtar

Znj. Joana Sorraj – Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik, në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidat: Dorina Dervishaj

Objekti: Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidataturës të kandidatës znj. Dorina Dervishaj për vendin vakant të inspektorit jomagjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë më datë 26.05.2026.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Pasi shqyrtoi relatimin e anëtarëve të KEV, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar (*në vijim "ligji nr.115/2016"*), pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit" (*në vijim "VKM nr.536, datë 25.07.2019"*), urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" (*në vijim "Urdhri nr. 7, datë 04.03.2020 i ILD"*), me njoftimin e datës 26.05.2026, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 5 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 88 datë 29.06.2026 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve (KEVI), si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. KEVI, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim që ishte data 25.06.2026, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 02.07.2026, ku vendosi për shqyrtimin e dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. KEVI ka publikuar në faqen zyrtare të ILD-së, në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jomagjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 dhe të VKM nr.536, datë 25.07.2019.
4. Znj. Dorina Dervishaj, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. 2001 prot., datë 24.06.2026 për vendin vakant të Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen

e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016, të VKM nr.536, datë 25.07.2019, si dhe Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020 i ILD. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Nëpërmjet këtij njoftimi, kandidatja është informuar se duhej të paraqitej pranë ambienteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda afatit 10 (dhjetë) ditor nga data e njoftimit individual në adresën elektronike të deklaruar prej saj (Dorina.Dervishaj@amf.gov.al) në dokumentacionin e aplikimit, me qëllim pajisjen me formularët dhe autorizimet e përcaktuara në pikën 14 të Kreut III të VKM nr.536, datë 25.07.2019. Po në të njëjtin njoftim është kërkuar konfirmimi i menjëhershëm i marrjes dijeni në adresën elektronike të përcaktuar për procedurën.
6. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se kandidatja, në datën 06.07.2026, ka konfirmuar marrjen në dijeni të njoftimit me përmbajtjen: *"Konfirmoj marrjen në dijeni të njoftimit për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për kandidaturën si Inspektor Jomagjistrat."*
7. Pavarësisht marrjes dijeni të njoftimit, kandidatja nuk është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda afatit 10 (dhjetë) ditor të përcaktuar në njoftimin individual, afat i cili ka përfunduar në datën 16.07.2026 dhe as pas përfundimit të këtij afati. Konkretisht, si pasojë e mosparaqitjes së saj, nuk është bërë e mundur pajisja me:
 - formularin "Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë";
 - formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015;
 - formularin e aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", sipas ligjit nr. 45/2015;
 - formularët për dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale;
 - formularët autorizues për kryerjen e verifikimeve në subjektet publike dhe private;
 - formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktin telefonik.

II. Vlerësimi i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit

8. Nga dokumentacioni i administruar në kuadër të procedurës së verifikimit rezulton se kandidatja është njoftuar rregullisht për detyrimin e paraqitjes pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për t'u pajisur me formularët e deklarimeve dhe autorizimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit. Kandidatja është vënë në dijeni se

paraqitja për tërheqjen e formularëve përbën një detyrim procedural të domosdoshëm për realizimin e verifikimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

9. Pika 14 e VKM nr. 536, datë 25.07.2019, parashikon detyrimin e kandidatit për t'u paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qëllim pajisjen me formularët përkatës të deklarimeve dhe autorizimeve. Gjithashtu, kjo dispozitë parashikon se, në rast pamundësie objektive për t'u paraqitur, kandidati ka detyrimin të njoftojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe të paraqesë shkaqet përkatëse justifikuese. Megjithëse është njoftuar në mënyrë të rregullt dhe ka marrë dijeni për detyrimet e saj procedurale, kandidatja nuk është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nuk ka paraqitur ndonjë shkak objektiv që të justifikojë mosparaqitjen. Për më tepër, ajo nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për shtyrje afati apo ndonjë komunikim zyrtar që të tregojë vullnet për vijimin e procedurës administrative.
10. Në mungesë të këtyre dokumenteve, nuk ka qenë e mundur kryerja e veprimeve procedurale të domosdoshme për vijimin e procedurës administrative të verifikimit të figurës, pasurisë dhe përmbushjes së kushteve ligjore për kandidimin. Komiteti vlerëson se mosparaqitja e kandidates, pavarësisht njoftimit të rregullt dhe mungesa e çdo shkakut objektiv justifikues, përbën mospërmbushje të detyrimeve procedurale që varen ekskluzivisht nga vullneti dhe veprimi i kandidates. Kjo sjellje procedurale ka penguar autoritetin kompetent KEVI-n në ushtrimin e detyrimit ligjor për kryerjen e verifikimeve të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore.
11. Pika 21 e VKM nr. 536, datë 25.07.2019, parashikon se, kur kandidati nuk paraqitet, nuk i përgjigjet njoftimeve të Inspektorit ose nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar, Inspektori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara.
12. KEVI vëren, se VKM nr. 536, datë 25.07.2019 dhe urdhri nr. 7, datë 04.03.2020, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e mosparaqitjes së kandidatit për inspektor jomagjistrat për të tërhequr formularët dhe autorizimet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi dhe, për pasojë, mosdepozitimin e tyre, si dhe mënyrën e disponimit të KEV në raste të tilla.
13. KEVI çmon të evidentojë, se Kodi i Procedurave Administrative (ligji nr. 44/2015), në nenin 94, parashikon: “[...] 2. Organi publik mund të deklarojë përfundimin e procedurës së nisur me kërkesë, pa vendim përfundimtar edhe nëse rezulton qartazi nga rrethanat se pala që ka paraqitur kërkesën, nuk ka më interes për vazhdimin e procedurës dhe e ka braktisur atë. 3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë

që mund të fillojë vetëm me kërkesën e palës. 4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij Kodi. 5. Braktisja e procedurës nuk e shuan të drejtën, të cilën individit kishte kërkuar të njihej”. Ndërsa, neni 95 i po këtij Kodi, parashikon: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”

14. KEVI vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidates Dorina Dervishaj. Kandidatja është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet rrugës elektronike në datë 06.07.2026. Kandidatja Dervishaj, me email të datës 06.07.2026, ka konfirmuar marrjen në dijeni të njoftimit me përmbajtjen: *"Konfirmoj marrjen në dijeni të njoftimit për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për kandidaturën si Inspektor Jomagjistrat."* Ndërsa nuk është paraqitur për të tërhequr formularët pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda afatit 10 (dhjetë) ditor të përcaktuar në njoftimin individual, afat i cili ka përfunduar në datën 16.07.2026 dhe as pas përfundimit të këtij afati.
15. Për sa më lart, KEV vlerëson të rregullt procedurën e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit për kandidaten Dorina Dervishaj. Në analizën tërësore të fakteve dhe rrethanave, për sa kohë që nga rrethanat rezulton qartësisht se kandidatja, Dorina Dervishaj, nuk është paraqitur për të tërhequr formularët dhe autorizimet me qëllim plotësimin dhe dorëzimin e tyre pranë ILD-së, si dhe nuk ka paraqitur asnjë arsye për mosparaqitjen e saj, procedurat e mëtejshme të verifikimit, duhet të ndërpriten.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 209 dhe 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, të pikave 21 dhe 24 të VKM nr.536, datë 25.07.2019, të Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020 të ILD, si dhe të neneve 94 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidataturës të kandidates znj. Dorina Dervishaj për vendin vakant të inspektorit jomagjistrat, shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë më datë 26.05.2026.
2. Në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit

të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, ky vendim ti njoftohet kandidates Dorina Dervishaj.

3. Kandidate Dorina Dervishaj, ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE


ANËTAR

Daniela Sulaj



KRYETAR

Eugen Nasufi



ANËTAR

Joana Sorraj

